



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC

Adresa :Bulevardi “ Reshit Çollaku “, lagjia nr 2

Tel. + 355(83)22222

LEJË INFRASTRUKTURE
nr. 3893 prot. datë 16/08/2020

I jepet zhvilluesit: “BASHKIA POGRADEC”

Leja e ndërtimit për punimet në objektin: " *Rehabilitimi i rrugëve, shesheve e fasadave, blloku tek lagja nr.2" në pronësi të Bashkisë Pogradec.*

Adresa e realizimit të punimeve: *Bashkia Pogradec*

Afati kohor i kësaj leje është: *16 muaj nga dita e fillimit të punimeve*

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të respektohet destinacioni i zhvillimit si dhe treguesit e zhvillimit sipas projektit të infrastrukturës dhe planvendosjes të miratuar.
2. Të respektohet rradha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve.
3. Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambjenti përreth.
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike, sipas projektit të miratuar, të jetë i pranishëm specialisti i zonës ose përfaqësuesi i ndërmarrjes apo institucionit përkatës dhe kushtit të vendosur nga OSHEE si më poshtë :
-Sheshi i ndërtimit në pjesë të veçanta intersektohet me linjat nëntokësore TM, TU, pjesë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe për punime në fasada ka kablo te furnizimit të abonentëve në TU. Gjatë zbatimit të punimeve subjekti zbatues duhet për çdo segment të marrë azhornimin e rrjetit TM, TU nga specialistët e OSHEE Agjensia Pogradec. Të gjitha punimet do të kryhen nën mbikqyrjen e specialistëve të OSHEE, Agjensia Pogradec. Në rast të dëmtimit të kabllave subjekti do të zëvendësojë kabllo të dëmtuara me shpenzimet e veta.
5. Të respektohen normat dhe standartet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.
6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoriteti i kontrollit të zhvillimit dhe inspektoriatit përkatës në fushën e ndërtimit
7. Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj.
8. Përpara ndërhyrjes në territor zhvilluesi duhet të njoftojë pranë DPKZHT për çdo segment, në përputhje me projektin e miratuar.
9. Afati i fillimit të punimeve është 1(një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.
10. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjëndjen e mëparshme.
11. Të respektohen kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

MIRATUAR :

VENDIM TË KRYETARIT TË BASHKISË
Nr. 239 , Datë 25/09/2020

KRYETAR I BASHKISË
ILIR XHAKOLLI